

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Shëndetësisë dhe Mireqenies Sociale
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/transpozim i BE-së/ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva / Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Jepni titullin e strategjisë ose të dokumentit të politikave që ka të bëjë me projektligjin.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	25/02/2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	25/03/2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	JO Data e shqyrtimit
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Viti– ML – Nr. VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Vojsava.Gjoliku@shendetesia.gov.al Ervina.Lila@shendetesia.gov.al
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë.</i> Problematikat gjatë zbatimit të ligjit Nr.10093, datë 9.3.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” kanë diktuar si nevojë ndryshimet e propozuara, të cilat do të ndikojnë në mbarvajtjen e veprimtarisë së AMSHC-së dhe rritjen e efikasitetit institucional në mbështetje të shoqërisë civile. Gjithashtu, ky ndryshim vjen në vijim të gjetjeve nga Raporti i SiGMA i kryer në vitin 2025, lidhur me “Forcimin e qendrës së qeverisjes në Shqipëri”.	
OBJEKTIVAT	
<i>Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit?</i> 1.Forcimi i koordinimit institucional dhe qartësimi i përgjegjësiave ndërmjet AMSHC-së, ministrisë përgjegjëse dhe Këshillit të Ministrave.	

2. Rritja e efikasitetit institucional përmes harmonizimit të dispozitave ligjore me legjislacionin për shërbimin civil.
3. Rritja e transparencës dhe sigurisë juridike në vendimmarrjen e Bordit Mbikëqyrës.
4. Përmirësimi i procedurave të përfaqësimit të organizatave të shoqërisë civile në strukturat drejtuese të Agjencisë.
5. Forcimi i parimeve të qeverisjes së mirë dhe koherencës së politikave, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme.

Opsioni 0, ruajtja e status quo-së.

Ligji aktual është hartuar në vitin 2009 dhe që atëherë nuk ka patur ndryshime. Me qëllim rregullimin e problematikave që kanë dalë gjatë zbatimit të ligjit ka lindur nevoja për ndryshime.

Opsioni 1, hartimi i një ligji të ri.

Një opsion i tillë mundëson hartimin e një kuadri rregullator të ri. Duke qenë se ndryshimet dhe shtesat e propozuara nuk bëjnë ndryshime thelbësore por rregullojnë disa problematika të lindura gjatë zbatimit të ligjit në praktikë, ky opsion nuk është i preferuar.

Opsioni 2, bërja e ndryshimeve në ligjin aktual, është më i volitshëm përderisa qëllimi është të amendohen disa aspekte të ligjit që nuk prekin thelbin e tij.

Kostoja do të ishte njëlloj si për opsionin 1 por meqënëse nuk ndryshon thelbi i ligjit, në këtë rast teknika legjislative sugjeron që të procedohet me këtë opsion dhe të bëhen shtesa dhe ndryshime në ligjin ekzistues.

Opsioni 3, nxjerrja e akteve nënligjore për të rregulluar situatën e krijuar, nuk mund të përdoret pasi organizimi dhe funksionimi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në vijim AMSHC dhe përcaktimi i procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile, janë është rregulluar fillimisht me ligj. Kësisoj, ai mund të ndryshohet vetëm me një akt ligjor dhe jo një më i ulët në hierarkinë e akteve ligjore të përcaktuara nga Neni 116 i Kushtetutës.

Opsioni 4, rregullimi me anë të një akti jorregullator.

Është vlerësuar edhe mundësia e implementimit të kësaj politike nëpërmjet një opsioni jo rregullator, por duke qenë se rregullimi i kësaj politike është bërë me ligj, ky nuk është opsion i preferuar.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura.

Opsioni i preferuar është Opsioni 2.

Zgjedhja e opsionit për ndryshimin e ligjit pritet të forcojë koordinimin institucional dhe të qartësojë përgjegjësitë ndërmjet AMSHC-së dhe ministrisë përgjegjëse, duke përmirësuar procesin vendimmarrës. Ndryshimet rrisin transparencën dhe sigurinë juridike, veçanërisht në lidhje me vendimet e Bordit Mbikëqyrës dhe të drejtën e ankimit. Gjithashtu, harmonizimi me legjislacionin

për shërbimin civil garanton stabilitet administrativ. Në tërësi, projektligji kontribuon në rritjen e efikasitetit institucional dhe forcimin e qeverisjes së mirë.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Bërja e ndryshimeve në ligjin aktual, është më i volitshëm përderisa qëllimi është të amendohen disa aspekte të ligjit që nuk prekin thelbin e tij.

Kostoja do të ishte njëlloj si për opsionin 1 por meqënëse nuk ndryshon thelbi i ligjit, në këtë rast teknika legjislative sugjeron që të procedohet me këtë opsion dhe të bëhen shtesa dhe ndryshime në ligjin ekzistues.

Projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominale)

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI PUBLIK

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer apo që planifikohet të kryhet (Metodat e ndjekura/që do të ndiqen; grupet e interesit që janë konsultuar/që do të konsultohen; rezultatet e pritshme/faktike të procesit?)

Projektakti është publikuar për konsultim publik në faqen e RENJKP më datë 25.02.2026.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Monitorimi i zbatimit të këtij projektligji do të realizohet nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale, nëpërmjet raportimit periodik të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mbi zbatimin e dispozitave të reja. Vlerësimi do të mbështetet në indikatorë të matshëm që lidhen me efikasitetin institucional, transparencën e vendimmarrjes dhe përputhshmërinë me legjislacionin për shërbimin civil. Pas një periudhe zbatimi, do të kryhet një vlerësim i ndikimit për të analizuar efektivitetin e ndryshimeve të ndërmarra.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR

Evis SALA